

VENDIM
Nr. 672, datë 3.10.2012

PËR AUTORIZIMIN E “ZODIAC” SHPK PËR IMPORTIN E MBETJEVE METALIKE TË ALUMINIT, BAKRIT, BRONZIT, TUNXHIT DHE ZINKUT PËR QËLLIME RICIKLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e “ZODIAC” sh.p.k., për importin e mbetjeve metalike të aluminit, bakrit, bronzit, tunxhit dhe zinkut, për qëllime riciklimi, me Kodin Doganor:

- GA 7602 00 mbetje dhe kthime të aluminit;
- GA 7404 00 mbetje dhe kthime të bakrit (bronzit, tunxhit);
- GA 7902 00 mbetje dhe kthime të zinkut;

dhe kodin B1-B1010 të Konventës së Bazelit, aneksi 1 “Mbetjet e listës së gjelbër”, referuar vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, të ndryshuar.

2. Sasia e mbetjeve metalike të aluminit, bakrit, bronzit, tunxhit dhe zinkut, që importohet, sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 7 000 (shtatë mijë) tonë.

3. Mbetjet do të importohen nga Mali i Zi, Kosova, Maqedonia, vendet e BE-së dhe Lindja e Mesme. Transporti do të bëhet në rrugë tokësore dhe detare, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr. 806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve me qëllim përdorimi, përpunimi dhe riciklimi”. Ambalazhimi i tyre do të bëhet në paleta, i presuar ose në thasë plastikë, konform aneksit III të vendimit nr. 550, datë 22.8.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”. Për çdo transfertë ndërkufitare të mbetjeve, “ZODIAC” sh.p.k., dorëzon të plotësuar, në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, dokumentin e lëvizjes/transfertës ndërkufitare të mbetjeve, sipas formatit të dhënë në aneksin IV të vendimit nr. 550/2012 të Këshillit të Ministrave, ndërsa monitorimi i tyre do të kryhet nga strukturat përkatëse të doganave. Çdo transfertë mbetjesh duhet të jetë e pajisur me raport-analizë, të kryer për aspektin e radioaktivitetit.

4. Periudha e lejit të importit të mbetjeve metalike të aluminit, bakrit, bronzit, tunxhit dhe zinkut nga “ZODIAC” sh.p.k., do të jetë për një afat kohor 1-vjeçar (njëvjeçar), nga data e miratimit në Këshillin e Ministrave.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore, merr masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve metalike të aluminit, bakrit, bronzit, tunxhit dhe zinkut nga “ZODIAC” sh.p.k., pas miratimit të këtij vendimi, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon, me shkrim, me shtetet eksportuese dhe ato transitore për autorizimet përkatëse, që lejojnë kalimin e kësaj sasie të mbetjeve të aluminit, në përmbushje të kërkesave të konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha